



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 09 shtator 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

Përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2026, në masën 18.22 lekë/kWh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Miratoi rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Licenca rinovohet për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 03.12.2026.

Miratoi rinovimin e licencave të shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., përkatësisht:

- në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 22.12.2026;
- në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 22.12.2026.

Miratoi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019 “Mbi licencimin në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e regjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG” i ndryshuar”.

Në kuadër të çështjeve të tjera, Bordi i ERE-s miratoi “Udhërrëfyesin mbi shërbimet që ofrohen nga Enti Rregullator i Energjisë”. Udhërrëfyesi ka karakter informues dhe orientues dhe synon të informojë subjektet e rregulluara, klientët, investitorët dhe palët e tjera të interesuara mbi kompetencat, shërbimet dhe procedurat që administrohen nga ERE.

Udhërrëfyesi nuk krijon të drejta ose detyrime të tjera përtej atyre të përcaktuara në legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi dhe nuk zëvendëson procedurat, kushtet, kriteret apo dokumentacionin e përcaktuar në aktet përkatëse të ERE-s.

Vendimet e plota të Bordit të ERE-s janë të aksesueshme në faqen zyrtare të ERE-s dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.